



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
RÉPUBLIQUE DU KOSOVO  
KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC  
Nr. Br. No. 01-060-01-32823-24  
Nr. i fq. / Br.str. / Nö.pg.  
Data / Datum / Date 21-10-2024  
OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ  
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal e mbajtur me dt. 26.09.2024, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari (IQO), Labinot Mirena (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Lendita Krasniqi, (LVV), Valon Svirca (LVV), Albana Shillova Shalaku, (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi, (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

Të pranishmit tjerë: drejtoret komunal, Afërdita Hashani, udhëheqëse e sektorit të tatimit në pronë Rexhep Zeka, shef për arsim të mesëm, përf. e OSBE-së dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi anëtarë më i vjetër i Kuvendit Komunal, Enver Gashi i cili pasi konstataoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planifikimit të Buxhetit 2025 dhe Parashikimi për vitet 2026-2027
4. Shqyrtimi për Draft Planin Zhvillimor Komunal të Arsimit 2025-2029
5. Shqyrtimi i Raportit të Performancës Komunale për vitin 2023
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-Vendimit për caktimin e normave tatimore për vitin 2025
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 20 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Vlora Mjekiqi Kabashi

Pika 2 e rendit të ditës

Sami Ahmeti – Po thoni ekstrakteve ndërsa, këtu në dokumente e kemi vetëm një procesverbal dhe normal do të duhej të ishte vetëm një procesverbal dhe pse janë ekstrakeve nuk e di.

Kryesuesi – Mua, nga sekretaria më është thënë se janë dy procesverbale, një nga mbledhja e rregulltë dhe një procesverbal nga mbledhja e jashtëzakonshme.

Miratohen ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara me 15 vota për dhe 4 vota abstenim.

### Pika 3 e rendit të ditës –

**Kryesuesi** – Paraqiti shqyrtimin dhe planifikimin e buxhetit 2025 dhe parashikimet për vitet 2026-2027. Unë e kam thënë në mbledhjen e KPF-së dhe po e them prapë se investimet kapitale, shpenzimet e pagave dhe meditjeve gati po shkojnë barabarë që është një e mirë sepse ky Kuvend përpara ka votuar buxhet që ka qenë 60-70 % paga dhe meditje ndërsa, tjerat kanë qenë investime. E mira tjetër është se të hyrat vetanake për çdo vit kanë rritje dhe ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar këtë buxhet, si dhe e kemi përkrahë.

**Sami Ahmeti** – Realisht është një buxhet i madh që për kokë banori nëse, ka një politikë të mirë zhvillimore do të ishte shumë i mirë. Forma dhe orientimi që është ndarë ky buxhet ne konsiderojmë se ka gabime të mjaftueshme dhe nuk garanton qëndrueshmëri, aq më tepër zhvillim për qytetarët e Komunës së Obiliqit. Së pari te pagat dhe meditjet, nuk qëndron ajo që po shkojnë bashkë do të thotë dallimi është në buxhetin për vitin 2025 dikund 400,000 euro, që pagat dhe meditjet vazhdojnë të marrin pjesën kryesore të buxhetit, që do të thotë që mbushja e institucioneve me punëtorë, ose militantë po vazhdon. Ne nuk kemi asgjë kundër punonjësve që meritojnë të vlerësohen për punën e tyre, por shpenzimet që po bëhen vetëm për çështje klanore ose partiakë besojmë që nuk janë në rregullë. Gjithashtu, edhe te subvencionet, mendojmë se ndarja e këtyre subvacioneve nuk është një plan i mirëfilltë, që do të bënte që subvencionet të shkojnë në vendin ku do të duhej të shkonin dhe të zhvillohej qoftë bujqësia, apo fushat e tjera. Ndërsa sa i përket investimeve kapitale në këtë buxhet për të tretin vit, ose të katërtin vit radhazi investime kapitale realisht nuk ka, është vetëm një projekt ndaj të cilit ne nuk kemi asgjë kundër, por nëse specifikojmë vitin 2025 dikund 88.13 % e buxhetit në investime kapitale orientohet në kogjenerim. Ne nuk kemi asgjë kundër kogjenerimit dhe e dimë që është projekt me rëndësi. Mirëpo, në një gjendje normale një buxhet që konsiderohet absolut dhe të ndahet vetëm një projekt, projekt ky që do të mbuloj vetëm një pjesë të qytetarëve dhe banorëve të Komunës tonë sepse projekt i kogjenerimit në formën më të përpikët të tij parashevë shtrirjen e tij në 5 kilometra në zonën rrëth Termocentraleve. Ne mendojmë se është i ndarë dhe orinetuar gabimisht nuk garanton zhvillim, nuk garanton kushte më të mira, madje as bazike siç do të duhej të ishin, po e zëmë një parking afër varrezave të qytetit që sa herë ka ceremoni të varrimit rrezikohen këmbësorët, rrezikohen pjesëtarë të tjerë të komunikacionit. Pastaj, edhe vendosja e lifteve nëpër banesa të qytetit, do të thotë nuk ka ndonjë zhvillim ky buxhet 88.13 % orientohet vetëm në projekt dhe kjo pastaj po shitet edhe si nivel i lartë i performancës sepse ne e dimë që performanca në institucion matet me harxhim të buxhetit. Kjo, do të thotë se janë harxhuar të gjitha mjetet, por ato të gjitha po shkojnë në një fushë. Si i tillë që është ky buxhet edhe pse e dimë që është i rëndësishëm dhe dokumenti kryesor që Kuvendi komunal duhet ta nxjerrë, ne si grup jemi kundër.

**Ajet Berisha** – Ajo që vërehet në këtë buxhet, është se nuk është paraqitë fleta ose pasqyra e cila i tregon të hyrat në kuptimin e pasqyrimit të grandit për shëndetësi, arsim dhe grandit tjetër për të hyrat vetanake. Kjo, do të thotë se nuk kemi asnjë udhëzim se nga kanë me qenë të hyrat, por hyjmë në totalin e buxhetit i cili pastaj tregon se nga ka me u bë shpenzimi. Mendoj se në kuadër të linjave, shpërndarja përmallra e shërbime, paga dhe meditje, shpenzime komunale, subvacione dhe investime kapitale, i pamë në përgjithësi dhe nga vitet e kaluara, e jo vetëm të viteve të afërta. Ne kemi një rritje të buxhetit si total, rritje të pagave dhe meditjeve gjithsesi, por edhe rritje të mallrave dhe shërbimeve, do të thotë një vlerë kogja e konsiderueshme normal edhe të subvacioneve. Unë mbajë në mend se buxheti i Komunës si total nuk ka qenë sa janë subvencionet tash, do të thotë si Kuvend komunal kemi miratuar buxhet me 700,000 euro, dhe kur ka mbërrit në një milion kogja jemi gjëzue. Buxheti si total është vlerë kogja e madhe sidomos në proporcione për kokë banori në rast se nuk kishim me mbetë vetëm te ky investim, ose vetëm te këto mjete sepse ne kemi edhe Qeveri, që kishte mund edhe ajo me ndihmues prapë që me sjellë një pozitë pak më të favorshme për qytetarët e Obiliqit. Vërejtja ime fillestare është që mungon pasqyra e të hyrave dhe e dyta është se te mallrat dhe shërbimet mendoj që është vlerë shumë e lartë, një milion e 900,000 euro, që përmua është një vlerë që shkon ekskluzivisht në dëm të investimeve kapitale. Te subvencionet, mendoj se në

rast se ndahan mirë është një vlerë kogja e konsiderueshme dhe në rast se këto kanë me shkue te ata që vërtetë, kanë nevojë me u subvencionue në kuptimin o shëndetësor, o zhvillimor, o bujqësor që kishin me krijue edhe të hyra, që kishim me pasë një shëndet më të mirë dhe zhvillim ekonomik për Komunën. Ajo çfarë e kemi diskutue edhe te KAB-i, e përshëndes rritjen që është bërë për shëndetësi dhe kjo është shumë me interes duke e parë se në vitin e kaluar kanë qenë 161,000 euro, mungesat të cilat kanë reflektue në ambullantat tona kanë qenë kogja të rrezikshme. Prandaj, kjo mbulesë shpresoj edhe në vitet e ardhshme se po e shohë që në vitet e ardhshme është një ulje, me mbetë ky buxhet konstant për shkak të nevojave sepse deri më tash barnat esenciale kanë ardhë prej Qeverisë muaj për muaj, ndërsa tash po vijnë çdo 3 muaj dhe këtu, nuk po ka ndonjë siguri me dështue ndonjë tender se deri më tash kanë dështue kogja shumë. Në QKMF kemi mbetë sidomos me ato shërbime që janë urgjente për me u ofrue, kanë mbetë në pozitë shumë të rëndë kështu që është mirë këto me i paraparë. Ajo që nuk shohë se është përfshirë ose nuk kam informatë kisha dashur se e kemi diskutue me Nënkyryetarin, është një pjesë e punëtorëve të QKMF-së, që është e angazhuar përmes Relief-it islamik, që nga rritja e koeficientit apo arritja e Ligjit të pagave dhe ajo pjesë e punëtorëve ka mbetë me të vjetrën, Pra, mjekët dhe infermierët në një formë janë të diskriminuar me paga më të ulëta kur punën e bëjnë të njejtë, do të thotë janë duke e kryer një shërbim jashtëzakonisht të vyeshëm shërbimin paliativ, që është i domosdoshëm për me funksionue në këto rrethana. Mendoj se janë dikund 20 terrene që i shfrytëzojnë për çdo ditë, kështu që iu kisha lutë një kalkulum që ndoshta nuk është krejtë i saktë, por mund të kalkulohet nga Drejtoria e financave dhe në atë kohë kur e kemi kalkulue kur është bërë Ligji i pagave, ndryshimi që është dashur me u mbulue ka qenë 73,000 euro. Për këtë çështje ka mund me u marrë vesh me Reliefin islamik, ose me mbulue vetë Komuna sepse sa e di unë 60 me 40 është proporcioni dhe ne e kemi pasë qind për qind me organizatën tjetër caritas dhe kjo është një mbulesë kogja e mirë. Tash, më duket ka mbetë një vit e pak që me 25,000 euro, kishte me u mbulue që me u heqë ky diskriminim për këta punëtorë të stafit shëndetësor në QKMF dhe me u ndje të diskriminuar ata me paga dikund prej 30-40 % më të ulëta. Ju lus me gjetë këtë mundësi që këtë marrëveshje me rishikue dhe kjo pjesë në rast se nga pala kontraktuese nuk mbulohet këto 25,000 euro me u mbulue nga ana e Komunës, që mendoj se ka hapësirë dhe mundësi. Ajo që e tha parafolësi rreth investimeve kapitale nuk po hy me i detajue më thellë mallrat dhe shërbimet, që unë mendoj se është vlerë shumë e lartë që është dashur me u rishikue dhe zvoglimii i mallrave dhe shërbimeve është dashtë me shkue në kuadër të investimeve kapitale. Është e vërtetë, se jo vetëm viti 2025 por edhe 3 vitet e kaluara është që projekti i kogjenerimit ka marrë masën më të madhe të mjeteve në investimet kapitale. Unë me heret e biseduam me kolegut z.Sami, pavarësisht sa është i domosdoshëm ky projekt që për neve, është shumë i nevojshëm dhe i domosdoshëm mendoj se përcaktimi në këtë formë për realizimin e këtij projekti me 80 % të investimeve kapitale me shkue në këtë projekt nuk është krejtë në favorin e qytetarëve, sepse një masë e madhe e investimeve tjera kapitale po mbeten mangut. Unë po e shpjegoj përmes këtij viti përveç një milion jashtë pjesës së kogjenerimit një milion mbeten investime tjera kapitale, nevojat janë shumë të mëdha. E shohë investimet kapitale që janë paraparë për sivjet 370,000 euro i merrë Arsimi, dikund 600,000 euro janë paraparë për sivjet nga Rregullorja për Arsimin për investim në vitin 2025. Unë po e marrë vetëm një shembull është një rrugë në Bakshi që në vitin 2019-2020 ka qenë paraparë me u rregullue rruga Bakshi-Llazarevë dhe lëre që nuk është rregullue, por asnjë guri kurrë nuk është vendos në atë rrugë. Po ashtu, ka fshatra tjerë që jo vetëm në vitin 2025, por edhe në vitet tjera absolut nuk preken me investime kapitale. Mendoj se sado që projektet e mëdha kanë me na ndihmues me interesin qytetar dhe me shpenzimin e buxhetit, kishte me qenë mirë më shumë se 1/3 e buxhetit për investime kapitale mos me shkue në asnjë projekt në këtë vit sepse kjo po na e merrë 80 % dhe 20 %-i, tjetër o Arsim, o shëndetësi, o investime tjera, po mbeten jashtëzakonisht keq. Unë nuk kam diçka tjetër përveç këtyre vërejtjeve dhe lutjeve, që ajo pjesë me u mbulue për punëtorët shëndetësor në kuadër të QKMF-së.

**Kryesuesi** – Duhet me ecë me kohën dhe nuk dua të japë sqarime se kam sqarime, së pari rruga Bakshi-Llazarevë ka probleme pronësore, edhe rruga Bakshi-Raskovë ka probleme pronësore, për atë edhe kanë

mbetë. Ne kemi zhvilluar bukur shumë projekte edhe në këtë mandatë dhe ta dini të gjithë se kjo tantiemë që merret më shumë merret përmirësimin e kushteve të ambientit. Ne e dimë se kogjenerimi është projekt i shtrenjtë, por është në atë domenin e përmirësimit të ambientit. Ne kemi bërë shumë kërkesa në organizata të ndryshme, por ende nuk kemi përgjegje pozitive dhe po duhet me shkue një buxhet i madh. Ne nuk jemi aq keq me infrastrukturën në përgjithësi në Komunën tonë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për 3 vota kundër dhe 4 vota abstenim e aprovuan Planifikimin e Buxhetit Komunal dhe projektet investuese për vitin 2025 sipas tabelës 4.1, 4.2, 4.3 dhe PCF-1, PCF-2, PCF-3 dhe PCF-4 sipas tabelës së specifikuar.

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti kërkësen nga Drejtoria e Arsimit për dhënien në debat publik të Draft Planit Zhvillimor Komunal të Arsimit dhe për sqarim fjalën ia dha përfaqësuesit të Drejtorisë së Arsimit.

**Rexhep Zeka** – Drejtoria e Arsimit ka hartuar një Draft Plan Zhvillimor për ngritjen dhe sigurimin e cilësisë në Komunën e Obiliqit, që përfshin mandatin 4 vjeçar 2025-2029 në bashkëpunim me Qendrën për Arsim të Kosovës. Ne jemi munduar që ti përfshijmë të gjithë faktorët të cilët ndikojnë në ngritjen dhe sigurimin e cilësisë, kështu që presim që ky Draft Plan të kaloj edhe në diskutime publike, të kthehet prapë në Kuvend për aprovim dhe të merrë fuqinë e vetë për veprim që nga viti 2025.

**Ajet Berisha** – Unë po i shmangu diskutimet, por vetëm një gjë Komisioni duhet ta ketë parasysh dhe nuk po flas për botën, por Kosova po përgatitet për një arsim gjithëditor. Ne po flasim për investime, apo për plane në materiale pune, apo në diçka që është gjithsesi e domosdoshme e planifikuar deri në vitin 2029, për 4 vjet, 4 milion ta keni parasysh se po flasim për arsimin, po flasim për një sektor që ka me na tregue të sotmen dhe të ardhmen, ka me na e drejtue. Kjo, është arsyaja që po themi ne se një projekt po i merrë investimet 80 % e po mbetet keq arsimi dhe shëndetësia. Në rast se sot nuk i kthejmë sytë nga Arsimi, pasojat do ti kemi me vite. Për me përcjellë trendin, mendoj se këtë Draft Plan duhet me tejkalue dhe ky Komision me qenë pak më ambicioz, që planet jo vetëm për mjete konkretizimin në arsim, apo edhe për zhvillim gjithsesi këto, nuk mohohen në asnjë formë për zhvillim të objekteve, infrastruktura dhe të arsimtarëve e profesorëve, por me shkue nga planifikimi që Obiliqi me pasë arsimin shkollën gjithëditore. Pra, me qenë pak më ambicioz edhe nëse, nuk ia qëllojmë ambicia nuk na dëmon, në të kundërtën ka me na ndihmuë që ne me i pasë synimet tona dhe me i drejtue investimet tona nga është e mira dhe zhvillimi. Meqë, ka kohë e lus Komisionin që ta shohë edhe këtë mundësi që edhe kjo pjesë 4 milionë që është paraparë, për mua është jashtëzakonisht pak për me mendue për investimet në arsim.

**Sami Ahmeti** – Ne e shqyrtuam edhe në mbledhjen e KPF-së, sepse kërkesa realisht nuk thotë për me dalë në debat publik. Ne e sqaruam këtë çështje, që është për debat publik dhe si rrjedhojë nuk është që jam marrë me këtë Draft Plan sepse kemi thënë se e japim pëlqimin. Pasi që e sqaruam në mbledhjen e KPF-së, e them me sinqueritet nuk është që e kam lexue me shpresën që delë në debat publik dhe ekspertët më të mirë e bëjnë këtë sa më mirë. Përveç, fakteve që i përmendi z.Ajet, unë kisha dashtë me shtue edhe një diçka, me shtue elementin që disa shkolla siç është ekonomia dhe gjimnazi, a vërtetë ne kemi nevojë në Obiliq me i pasë, që ti rritim më shumë profilet që ka nevojë KEK-u, dhe që ka nevojë punëtorët e Komunës tonë të rrinë dhe të mos vijnë prej Komunave tjera. Unë nuk kam diçka konkrete me thënë për këtë çështje, por ta rishikojmë se a ka mundësi me u bë diçka e tillë sepse jemi bë me shkolla të njejtë të gjitha Komunat kur ka mundësi me diçka me plotësue, pasi që ne e kemi korporatën si të veçantë që jemi. Ne jemi pro që kjo të shkoj në debat publik me shpresën që nëse, kemi mundësi me dhënë ndonjë kontribut.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 20 vota për morën Vendim për dhënien në debat publik të Draft Planit Zhvillimor Komunal të Arsimit 2025-2029.

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti shqyrtimin e raportit të performancës komunale për vitin 2023.

**Sami Ahmeti** – Në njëfarë mënyre Kuvendin komunal e kemi bërë sikur sistemin e Bolonjës në arsimin e lartë universitar ku testet dhe provimet bëhen me shkrim dhe kurrë nuk delë dikush përpara me bë një

prezentim, ose çka nëse, unë nuk e kam lexue këtë raport, që unë nuk e kam lexue me dalë përfaqësuesi, e jo vetëm me na dërgue me shkrim. Mirëpo, pasi që veç po e bëjnë një raport me dalë e me i prekë pikat kryesore ndërsa, ne me i dhënë komentet tona. Si i tillë rapporti e di që nuk votohet, por gjithsesi është mirë se Kuvendi është me folë përndryshe, ne mundemi me komunikue përmes emailave dhe me shkrim, që më duket jonormale por sido që të jetë e thashë se kjo nuk votohet.

**Ajet Berisha** – Ajo që kam parë te rapporti i performancës është një konstatim që Komuna e Obiliqit ka ulje në vlerësim në shumë fusha, prej 16 fushave në 2 fusha është nën mesatare të Komunave të Kosovës. Në disa fusha 5 ose 6 prej tyre është pak mbi mesatare ndërsa, në 4,5 fusha është mirë, është aty ku është dashtë me qenë. Duke u bazuar nga ajo që po lidhet konstatimi që e dhamë unë e parafolësi se kogjenerimi në vitet e fundit është duke na i marrë mjetet shumë dhe është duke na lënë keq në investimet tjera kapitale, po reflekton edhe te performanca. Mendoj se është mirë me pa dhe me konstatue se ka një ulje të performancës në Komunën e Obiliqit në krahasim me 2 vitet paraprake dhe është një ndezje e alarmit që kjo gjendje me u përmirësue. Kësaj radhe janë vlerësue 16 fusha me 85 tregues, apo indikatorë, kështu që shqetësimi është në vend se me shkue nga përmirësimi për çdo vit, me ra nuk kishte me qenë mirë për shkak se kemi një buxhet kogja të mirë për kokë banori ku përveç Prishtinës, apo ndonjë Komunë tjetër më e madhe mendoj se Obiliqi është i privilegjuar me këtë buxhet që këto elemente të performancës me u pa edhe në vlerësim. Është një pikë e dobët e kësaj qeverisje, duhet të ndezet alarmi dhe viti 2024, 2025 me qenë me performancë tjetër. Shpresoj që kjo me reflektue te qeverisja dhe mos me vazhduje degradimi në performancë.

**Kryesuesi** – Jeni të lirë jo vetëm ju, por edhe unë me juve bashkë për çdo paqartësi që vjen këtu në Kuvend, zakonisht drejtoret kur e parashtronjë kërkesën për ndonjë pikë të caktuar të rendit të ditës në Kuvend janë këtu dhe ju mund të pyesni, por jo për krejtë materialin sepse vërtetë mbledhja kishte me zgjatë shumë.

#### Pika 6 e rendit të ditës

**Kryesuesi** – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovin e Propozim-Vendimit për caktimin e normave tatimore përvitin 2025.

**Ajet Berisha** – Te neni 1.2 për vlerën e pronave mbi 100.000 euro, caktohet shkalla tatimore në lartësinë 0.20 plus tatimi thotë nga neni 1.1 i këtij neni. Tash, kjo delë 30 % ose plus ndoshta, 30 % jo se është vlerë më e madhe dhe unë nuk po e kuptoj. Nëse, e kemi pronën te 1.2, 499,000 euro, që e përfshin menjëherë me 0.20 % atëherë tatimi për këtë pronë është 999.99 euro, plus 100 euro nga neni 1.1 që në bazë të kësaj kështu po delë. Shkojmë te pika 1.5 që në bazë të kësaj është se është mbi 5 milionë euro, vlera po e njejta, por tash duhet me u mbledhë 100, 999, 2,999, 19,999 dhe 25,000 që shkon në 49,099 euro tatimi vjetor. Kjo, është kogja shumë e madhe dhe po shkon duke u mbledhë sepse thotë plus 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe vlera 0.50, a ka nevojë kështu me u bë sepse më duket e pakuptimtë dhe nëse, don me i shtue këto ia shton 0.6. Për mua, është shumë shtrenjtë dhe po ju paralajmëroj se është një ngritje jashtëzakonisht e tatimit që e pres për çdo vit se do të ketë ngritje, por kjo ka me ndikue kogja te qytetarët.

**Afërdita Hashani** – Ju sqaroj se është hera e parë që u bë ky ndryshim prej normave të mëhershme që kanë qenë për pronat komerciale të banimit. Tani, me Ligjin e tatimit kjo pjesa që është këtu, është identike qysh është e përcaktuar në Ligjin e tatimit. Te pika 1.1 dhe 1.5, për vlerën e pronave deri në 100,000 euro, tatohet shkalla tatimore në lartësinë prej 0.10 %. Ky 0.19 %-i, është nisma është fillimi i shkallës tatimore. Për vlerën e pronave mbi 100,000 euro, caktohet shkalla tatimore në lartësinë prej 0.20 %, plus tatimi nga paragrafi 1.1 i këtij neni. Normalisht që edhe për neve si zyre e taimit në fillim ka qenë e pakuptueshme dhe mundet me qenë për secilin, por sqarimi është për shembull nëse, një pronë e ka vlerën 300,000 euro, 100,000-i i parë tatimohet vetëm 10 % ndërsa, 20 % tatimohet pjesa tjetër e pronës. E njejtë çështje është edhe te vlera e pronës mbi 5 milionë, çdo normë tatimore deri në 100,000 euro deri në 10 %, mbi 200,000 - 500,000 euro, 30 %, deri në një milion tatimohet 40 % ndërsa shkon mbi 5 milionë është kjo vlera 0.50 %. Tash, qysh kanë me dalë, qysh kanë me u kalkulue në sistem atje, janë të rregulluara në Departament të Arsimit e shohim qysh dalin normat.

**Sami Ahmeti** – Drejtoresha na e shpjegoi që janë normat minimale të caktuara me ligj, pa dashtë me hy më thellë, duke pasë parasysh se është një ligj mbi bazën e të cilit janë bërë këto norma tatimore, ne jemi pro këtij vendimi.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 18 vota për dhe 2 vota abstenim morën Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025.

#### **Pika e 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti kërkesën nga Drejtoria e Arsimit për themelimin e Komisionit për përgjedhjen e drejtorit në SHFMU “Ibrahim Rugova” në Obiliq.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 5 vota abstenim morën Vendim për Themelimin e Komisionit për vlerësim dhe përgjedhës për pozitën drejtor në SHFMU “Ibrahim Rugova” në Obiliq me këtë përbërje: 1. Bashkim Ismaili, kryesues, 2. Ismail Shalaku, anëtar, 3. Përfaqësuesi nga MASHT-i, anëtar

#### **Pika 8 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Ju njoftoj se e kemi përgjegjen nga Drejtoria e shëndetësisë për anëtarin e grupit të LVV-së, z. Sami Ahmeti rrëth pyetjes lidhur me planin dinamik të ndërtimit të ambullantës. Punimet, mbindërtimi, dhe renovimi i QKMF-së, në Obiliq janë duke vazhduar sipas planit dinamik. Është shtuar katër i 2-të, ndërsa janë duke vazhduar punimet në katin e 3-të. Nëse, punimet vazhdojnë sipas planit dinamik këtu, përfshihen edhe kushtet klimatike dhe objekti pritet të përfundon brenda vitit 2025. Punimet nuk pengojnë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore. E kemi edhe një përgjegje nga Drejtoria për kulturë, rini dhe sport për anëtarin z. Labinot Mirena. Drejtoria në fjalë, njofton se rregullisht mirëmban objektet sportive duke mbështetur kështu aktivitetet e tyre sportive si dhe rasti i ndriçimit në Palestrën e sporteve “Adem Jashari”. Eshtë hartuar me kohë paramasa dhe gjatë këtyre ditëve do të bëhet renovimi komplet i ndriçimit përmes kontratave me NPL “Kastrioti” SH.A. në mënyrë që zhvillimi i garave dhe sportit të jetë në përgjithësi në nivelin e duhur si gjithnjë.

**Jeton Mjekiqi** – Ne e kemi marrë një vendim si Kuvend që të paguhen aksionarët e NPL “Kastrioti” por deri më tash nuk kemi marrë ndonjë përgjegje. Unë sa e di jam aksionar dhe nuk kemi marrë paga dhe dua të di se a duhet të bëhet plotësim ndryshimi i atij vendimi që ne e kemi marrë në Kuvend, apo ku është problemi.

**Kryesuesi** – Sqaron se vendimi është i ligjshëm dhe nuk do të ketë plotësim ndryshim të atij vendimi, por kjo çështje mbetet për Rregulloret e brendshme të NPL “Kastrioti” kur i bëjnë ata. Duhet me potencue prapë këtë që është për shqetësim sepse një Komision tjetër që është te “Pastrimi” e merrë kompenzimin ndërsa ky Komision nuk e merrë.

**Sami Ahmeti** – Unë për dallim nga parafolësi që ndoshta, me të drejtë kërkon që të potësohen kushtet për secilin dhe për çka do që është bërë vendimi këtu, unë kam një kërkesë prej disa qytetarëve të Lajthishtës, të cilët thonë se nga fshati Palaj e deri në Lajthishtë mungon ndriçimi dhe aty ku ka ndriçim ka prishje të madhe, kështu që qytetarët që dalin me ecë kryesisht rrezikohen edhe prej automjeteve. Mundësishët të shihet dhe të merret parasysh kjo çështje nëse, ka mundësu me u përmirësue.

**Jeton Mjekiqi** – Ne e kemi marrë një vendim përrugën Obiliq – Graboc dhe kurgjë diçka konkrete nuk kemi për asfaltim, ose për hapjen e dy pikave, që njërin prej pikave veç e ka largue KEK-u, për kartelat që ka pasë me i bë te ura, në dalje te Bellaqevci. Është vështirësuejeta kogja shumë dhe qytetarët nuk kanë qysh me udhëtue këndej, kështu që deshta me ditë a kemi ndonjë përgjegje zyrtare prej KEK-ut.

Mbledhja përfundoi në ora 12:25'

Bashk.prof.për punë të KK

  
Azize Zeneli

Kryesuesja e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ  
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

**IZVOD IZ ZAPISNIKA**

Sa sednica Skupštine opštine održane 26.09.2024.godine u 11:00 časova, u sali Skupštine opštine.  
**Prisutni članovi SO:** Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari (IQO), Labinot Mirena (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Lendita Krasniqi. (LVV), Valon Svirca (LVV), Albana Shillova Shalaku, (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi, (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristić (SL) i Biljana Spasić(SL).  
**Ostali prisutni:** opštinski direktori, Aferdita Hashani, šef sektora za porez na imovinu Rekhep Zeka, šef srednjeg obrazovanja, OEBS i KFOR.  
Sastanak je vodio najstariji odbornik Skupštine opštine Enver Gaši, koji je nakon konstatacije da ima kakuoruma započeo sastanak ovim:

**DNEVNIM REDOM**

1. Opravdanje za odsustvo
2. Usvajanje izvoda iz zapisnika sa prošlih sastanaka
3. Razmatranje i usvajanje Planiranja i prognoze budžeta za 2025. godinu za 2026-2027.
4. Razmatranje Nacrta opštinskog plana razvoja obrazovanja 2025-2029
5. Razmatranje Izveštaja o radu opštine za 2023. godinu
6. Razmatranje i usvajanje Predlog-odлуке o utvrđivanju poreskih stopa za 2025. godinu
7. Razmatranje zahteva
8. Razno

Presedavajući – upoznao je prisutne sa dnevnim redom koji je usvojen jednoglasno.

Tačka 1. dnevnog reda

Odsutna: Vlora Mjekiqi Kabashi

Tačka 2. dnevnog reda

Sami Ahmeti - Vi govorite o izvodima, dok ovde u dokumentima imamo samo jedan zapisnik i normalno bi trebalo da bude samo jedan zapisnik.

Presedavajući - Iz sekretarijata Skupštine su mi rekli da ima dva zapisnika, jedan sa redovnog i jedan sa vanrednog sastanka.

Izvodi iz zapisnika sa prethodnih sednica usvojeni su sa 15 glasova za i 4 uzdržana.

Tačka 3 dnevnog reda

**Presedavajući** – Predstavio pregled i planiranje budžeta za 2025. i projekcije za 2026-2027. Rekao sam to na sednici KPF-a, i ponavljam, da su kapitalne investicije, plate i rashodi skoro jednaki, što je dobro jer je ova Skupština ranije glasala za budžet koji je bio 60-70% za plate i rashode, dok su ostale bile investicije. Druga dobra stvar je što su lični prihodi za svaku godinu povećani i mi smo kao poslanička grupa usvojili ovaj budžet i podržali ga.

**Sami Ahmeti** – Realno to je veliki budžet po glavi stanovnika, ako postoji dobra razvojna politika, to bi bilo jako dobro. Forma i orijentacija kojom je rasporedjen ovaj budžet, smatramo da ima dovoljno grešaka i ne garantuje stabilnost, još razvoj za građane opštine Obilić. Prvo, plate i dnevnice ne idu zajedno, znači da je razlika u budžetu za 2025. godinu negde oko 400.000 evra, da plate i dnevnice i dalje uzimaju glavni deo budžeta, što znači da zaposljavanje institucija sa radnicima ili militantima se nastavlja. Nemamo ništa protiv zaposlenih koji zaslužuju da budu cenjeni svojim radom, ali troškovi koji se prave samo za klanska ili partijska pitanja za koje smatramo da nije u redu. Takođe, što se tiče subvencija, smatramo da dodela ovih subvencija nije pravi plan, koji bi doveo do toga da subvencije idu tamo idu i razvijaju bilo poljoprivrednu ili druge oblasti. Što se tiče kapitalnih ulaganja u ovom budžetu treću, odnosno četvrtu godinu zaredom, kapitalnih ulaganja zaista nema, to je samo projekat za koji nemamo ništa protiv, ali ako preciziramo 2025. godinu negde 88,13% budžeta za kapitalne investicije je orijentisan na parnom grejanju. Nemamo ništa protiv kogeneracije i znamo da je to važan projekat. Međutim, u normalnoj situaciji budžet koji se smatra apsolutnim i izdvaja se samo jedan projekat, ovaj projekat koji će obuhvatiti samo deo građana naše opštine jer projekat kogeneracije u najpreciznijoj formi predviđa njegovo produženje na 5. kilometara na području oko Elektrana. Mislimo da je podeljeno i pogrešno orijentisano, ne garantuje razvoj, ne garantuje bolje uslove, čak ni osnovne kako bi trebalo da bude. Treba uloziti u parking kod gradskog groblja jer, pešaci su ugroženi, od saobraćaj prilikom neke saharene. Zatim, i postavljanje liftova u gradskim stanovima, znači da nema razvoja, ovaj budžet 88,13% se izdvaja samo za projekat i to se onda smatra kao visok nivo učinka jer znamo da se učinak u institucijama meri po trošenje budžeta, što znači da su sva sredstva potrošena, ali sva idu u jednu oblast, iako znamo da je važan i glavni dokument koji Skupština opštine treba da izda, mi smo kao grupa protiv toga.

**Ajet Berisha** – Ono što se primećuje u ovom budžetu je da nije predstavljen nijedan list ili izvod koji pokazuje prihod u smislu da odražava grant za zdravstvo, obrazovanje i drugi grant za lična primanja. To znači da nemamo smernice odakle su prihodi, već ulazimo u ukupan budžet koji onda pokazuje koliko je potrošeno. Mislim da smo u okviru linija, distribucije robe i usluga, plate i dnevica, opštinskih troškova, subvencija i kapitalnih investicija, videli generalno i iz proteklih godina, ne samo poslednjih godina, imamo povećanje u budžetu u celini. Imam u vidu da budžet opštine u celini nije bio ono što su sada subvencije, to znači da smo mi kao Skupština opštine odobrili budžet od 700.000 evra i kada je dostigao milion bili smo veoma srećni. Budžet u celini je ogromna vrednost, posebno po glavi stanovnika, a da nam ne ostane samo za jednu investiciju, jer imamo i Vladu koja bi mogla da pomogne. Moja prva primedba je da nedostaje bilans uspeha a druga je da je roba i usluga za koju mislim da je veoma visoka vrednost, milion i 900.000 evra, što je za mene vrednost koja ide isključivo na štetu kapitalnih ulaganja.

Što se tiče subvencija, mislim da ako se dobro raspode, to je značajna vrednost i ako one idu onima kojima su zaista potrebne u zdravstvu, razvoju ili poljoprivredi, one bi takođe ostvarile prihode, što je dovelo do boljeg zdravlja i ekonomskog razvoja opštine. Ono o čemu smo razgovarali u SOB, pozdravljam povećanje koje je napravljeno za zdravstvo, s obzirom da je prošle godine bilo 161.000 evra, nestasice koje su se odrazile na naše klinike su bile rizicne. Zato se nadam da će ovo pokrivanje u narednim godinama smanjiti, pri čemu će ovaj budžet ostati konstantan zbog potreba jer su do sada esencijalni lekovi dolazili iz Vlade iz meseca u mesec, dok sada dolaze svaka 3 meseca i ovde nema garancije da će bilo koji tender propasti jer su do sada mnogi propali. U GCPM su ostale u veoma teškom položaju posebno one usluge koje se hitno nude, pa je dobro da su one predviđene. Ono što ne vidim jeli uključeno ili nemam informacije, jer deo radnika GCPM koji je angažovan preko Islamske pomoći od stupanja na snagu Zakona o platama deo radnika ostao pri starom. Dakle, doktori i medicinske sestre su na neki način diskriminisani nižim platama kada rade isti posao, palijativna služba koja je neophodna da funkcioniše u ovim okolnostima. Mislim da

ima negde oko 20 polja koje koriste svakog dana, pa vas molim da pokrijete negde oko 73.000 evra. Što se toga tiče, možete se složiti sa Islamskim reljefom, ili sama opština pokriva. Nešto više od godinu dana sto je ostalo sa 25.000 evra mozemo pokriti uklanjanje ove diskriminacije za ove zdravstvene radnike u GCPM. Molim vas da nađete priliku da razmotrite ovaj ugovor i da ovaj deo, u slučaju da ugovorna strana ne pokrije ovih 25.000 evra, pokrije Opština, za šta mislim da ima prostora i mogućnosti. Ono što je predgovornik rekao o kapitalnim investicijama ne ulazi u ideju robe i usluga, što mislim da je veoma visoka vrednost koju treba preispitati i smanjenje robe i usluga treba da ide u okvire kapitalnih investicija. Istina je da je ne samo 2025. godina već i prethodne 3 godine da je projekat kogeneracije dobio najveći iznos sredstava u kapitalnim investicijama. Ranije sam razgovarao sa kolegom gospodinom Samijem, bez obzira na to koliko je neophodan ovaj projekat, koji je nama veoma neophodan, mislim da je opredeljenje u ovom obliku za realizaciju ovog projekta sa 80% kapitalnih investicija nije u potpunosti u korist građana jer veliki broj drugih kapitalnih investicija ostaju u deficitu, osim milion iz kogeneracionog dela, milion ostaje za ostala kapitalna ulaganja, a potrebe su velike. Vidim kapitalne investicije koje su planirane za ovu godinu, 370.000 evra dobija obrazovanje, negde oko 600.000 evra je planirano za ovu godinu Uredbom o obrazovanju za ulaganje u 2025. Uzimam samo jedan primer put u Bakšiju. 2019-2020 godine bilo je predviđeno da se sanira, zatim put Bakšija-Lazarevo, na da je popravljen, ali na tom putu nikada nije postavljen kamen. Takođe, postoje i druga sela koja ne samo u 2025. već i u drugim godinama nisu zahvaćena kapitalnim ulaganjima. Nemam ništa drugo osim ovih primedbi i molbe da taj deo bude pokriven za zdravstvene radnike u okviru GCPM.

**Presedavajući** - Moram da idemo u korak sa vremenom i ne želim da dajem pojašnjenja jer imamo pojašnjenja, pre svega put Bakšija-Lazarevo ima imovinske probleme, put Bakšija-Raskovo takođe ima imovinske probleme. I u ovom mandatu smo lepo razvili mnoge projekte i svi treba da znaju da se ovaj bonus koji se najviše dobija uzima za poboljšanje uslova životne sredine. Znamo da je kogeneracija skup projekat, ali je u domenu unapređenja životne sredine. Uputili smo mnogo zahteva različitim organizacijama, ali još uvek nemamo pozitivan odgovor i treba da idemo na ogroman budžet. Nismo tako loši sa infrastrukturom uopšte u našoj opštini.

Nakon rasprave, odbornici Skupštine opštine sa 12 glasova za, 3 glasa protiv i 4 uzdržana usvojili Planiranje budžeta opštine i investicione projekte za 2025. godinu prema tabeli 4.1, 4.2, 4.3 i PCF-1, PCF-2, PCF-3 i PCF-4.

#### Tačka 4. dnevnog reda

**Presedavajući** - Izneo je zahtev Direkcije za obrazovanje za javnu raspravu Nacrta opštinskog plana razvoja obrazovanja.

**Rexhep Zeka** – Uprava za obrazovanje je izradila Nacrt plana razvoja za uspostavljanje i obezbeđenje Kvaliteta nastave Opštine Obilić, koja obuhvata 4-godišnji mandat 2025-2029 u saradnji sa Centrom za Obrazovanje Kosova. Pokušali smo da obuhvatimo sve faktore koji utiču na uspon i obezbeđivanje kontinuiteta, pa očekujemo da će ovaj Nacrt plana proći kroz javnu raspravu, zatim dobije sopstvenu moć za delovanje preko usvajanja na Skupštini.

**Ajet Berisha** – Izbegavao bih diskusiju, ali samo jednu stvar Komisija treba da ima na umu, i ne govorim o svetu, ali Kosovo se spremi za celodnevno obrazovanje. Govorimo o investicijama, ili o planovima u radnom materijalu, ili o nečemu što je ionako neophodno planirano do 2029. godine, za 4 godine, 4 miliona imajte u vidu da je reč o obrazovanju, govorimo o sektoru koji nas void u budućnost. To je razlog zašto kažemo da projekat uzima 80% investicija, a obrazovanje i zdravstvo su i dalje u lošem stanju. Dakle, malo ambicioznijim, jer, ambicija nam ne šteti, naprotiv, pomogla nam je da sagledamo svoje ciljeve i usmerimo svoja ulaganja ka dobrom i razvoju. Pošto ima vremena, molim Komisiju da uvidi i ovu priliku, da ovaj deo od 4 miliona koji je predviđen, izuzetno malo za razmišljanje o ulaganjima u obrazovanje.

**Sami Ahmeti** - O tome smo razgovarali i na sednici KPF-a, nakon što smo to razjasnili na sednici, mogu iskreno da kažem da ga nisam čitao sa nadom da će se pojavit u javnoj raspravi, a to najbolje rade stručnjaci. Pored činjenica koje je naveo gospodin Ajet, želeo sam da dodam još jednu stvar, da dodam element da nekim školama kao što su ekonomski i gimnazija, da li nam je zaista potrebno više u Obiliću, da povećamo profile koji su potrebiti KEK-u, te da radnici naše Opštine treba da ze zposle a ne da dolaze

iz drugih opština.Zalažemo se da ovo ide na javnu raspravu u nadi da ako budemo u prilici da damo neki doprinos.

Nakon rasprave, odbornici Skupštine opštine sa 20 glasova doneli su odluku da se Nacrt Opštinskog plana razvoja obrazovanja 2025-2029. godine uputi na javnu raspravu.

#### Tačka 5. dnevnog reda

**Presedavajući** – predstavio pregled izveštaja o radu opštine za 2023. godinu.

**Sami Ahmeti** – Na neki način Skupština opštine liči na bolonjski sistem u visokom univerzitetском obrazovanju gde se pišu testovi i ispiti i niko nikada ne izade sa prezentacijom, ili šta ako, ja nisam pročitao ovaj izveštaj.Kao takav, znam da se o izveštaju ne glasa, ali je ipak dobro što Skupština razgovara, inače možemo da komuniciramo putem mejlova i pismeno, što mi se čini nenormalnim.

**Ajet Berisha** – Ono što sam video u izveštaju o učinku je nalaz da opština Obilić ima pad u proceni u mnogim oblastima, od 16 oblasti u 2 oblasti je ispod proseka kosovskih opština. U nekim oblastima je njih 5 ili 6 nešto iznad proseka, dok je u 4,5 oblasti dobro.Na osnovu onoga što se povezuje, zaključak koji smo ja i prethodni govornik dali da kogeneracija poslednjih godina oduzima previše sredstava i loše nas ostavlja u drugim kapitalnim investicijama, što se takođe odražava na učinak. Mislim da je dobro videti i konstatovati da postoji pad učinka u opštini Obilić u odnosu na prethodne 2 godine i to je upozorenje da se ova situacija popravi. Ovoga puta je ocenjeno 16 oblasti sa 85 indikatora,tako da je zabrinutost, umesto da idemo na poboljšanje za svaku godinu, jer imamo dobar budžet po glavi stanovnika, osim Prištine, ili bilo koje druge veće opštine, mislim da je Obilić privilegovan sa ovim budžetom što su se ovi elementi učinka takođe videli u proceni. To je slaba tačka ove vlasti, 2024., 2025. godinu sa drugačijim učinkom. Nadam se da će se to odraziti na upravljanje i da se degradacija učinka neće nastaviti.

**Predsedavajući** - Ne samo vi, nego i ja sa vama slobodni smo za svaku nejasnoću koja dođe ovde u Skupštini, obično su direktori kada podnesu zahtev za određenu tačku dnevnog reda u Skupštini tu i možete da pitate, ali ne za sav materijal jer bi trajalo predugo.

#### Tačka 6. dnevnog reda

**Presedavajući** - Dao je na razmatranje Predlog-odлуку za utvrđivanje poreskih stopa za 2025. godinu.

**Ajet Berisha** – Kod 1.2, za vrednost imovine preko 100.000 evra, poreska stopa je 0,20 plus porez iz člana 1.1. Sada, to daje 30% ili plus možda, 30% nije da je to veća vrednost i ne shvatam je. Ako imamo imovinu od 1.2, 499.000 evra, što odmah uključuje 0,20%, onda je porez na ovu nekretninu 999,99 evra, plus 100 evra iz člana 1.1.Na tačku 1.5, na osnovu ovoga je preko 5 miliona evra, vrednost je ista, ali sada mora da se naplati 100, 999, 2.999, 19.999 i 25.000, što iznosi 49.099 evra godišnjeg poreza. Ovo je veoma veliki iznos i sabira se jer piše plus 1,1, 1,2, 1,3, 1,4 i vrednost 0,50, da li je to potrebno da se radi jer mi se čini besmislenim i ako želite da dodate ove dodajte 0,6 . Za mene je to veoma skupo i upozoravam vas da je to izuzetno visok porez za koji svake godine očekujem da će biti povecanje, ali to ima veliki uticaj na građane.

**Afërdita Hashani** – Pojašnavam da je ovo prvi put da je ova promena napravljena u odnosu na prethodne stope koje su bile za komercijalne stambene nekretnine.Sada je sa Poreskim zakonom ovaj deo koji je ovde identičan kako je definisan u Poreskom zakonu. U tačkama 1.1 i 1.5, za vrednost imovine do 100.000 evra, poreska stopa se oporezuje u visini od 0,10%,0,19% je početak poreske skale. Za vrednost imovine preko 100.000 evra, poreska stopa se utvrđuje u visini od 0,20%, uvećana za porez iz stava 1.1 ovog člana. Normalno da je i nama kao poreskoj u prvi mah bilo neshvatljivo,ali pojašnjenje je, na primer, ako je imovina vredna 300.000 evra, prvih 100.000 se oporezuje samo 10%, dok 20% se oporezuje na ostatak imovine. Isti je slučaj sa vrednostima imovine preko 5 miliona, svaka poreska stopa do 100.000 evra je do 10%, preko 200.000-500.000 evra, 30%, do milion se oporezuje sa 40%, dok preko 5 miliona ova vrednost je 0,50 %.

**Sami Ahmeti**– Direktorka nam je objasnila da su to minimalne stope utvrđene zakonom, ne želeći da idemo dublje s obzirom da je to zakon na osnovu kojeg su ove poreske stope donete, mi usvajamo ovu odluku.

Nakon rasprave, odbornici Skupštine opštine sa 18 glasova za i 2 uzdržana doneli su Odluku o utvrđivanju poreskih stopa poreza na nepokretnosti za 2025. godinu.

#### Tačka 7. dnevnog reda

**Presedavajući** - Predstavio je zahtev Direkcije za obrazovanje za formiranje Komisije za izbor direktora osnovne skole "Ibrahim Rugova" u Obiliću.

Odbornici Skupštine opštine sa 15 glasova za i 5 uzdržanih doneli su Odluku o formiranju Komisije za ocenjivanje i izbor direktora u školi „Ibrahim Rugova“ u Obiliću u sledećem sastavu: 1. Bashkim Ismaili. , presedavajući, 2. Ismail Shalaku, član, 3. Predstavnik MONT-a, član.

#### Tačka 8. dnevnog reda

**Presedavajući** - Imamo odgovor iz Direkcije za zdravstvo za člana grupe LVV, gospodina Samija Ahmetija u vezi sa pitanjem dinamičkog plana za izgradnju ambulante. Radovi na izgradnji i renoviranju GCPM u Obiliću se nastavljaju prema dinamičkom planu. Dograđen je 2. sprat, dok se na 3. spratu nastavljaju radovi. Ukoliko se radovi nastave po dinamičkom planu ovde su obuhvaćeni i klimatski uslovi, a završetak objekta se očekuje do 2025. godine. Radovi ne ometaju pružanje zdravstvenih usluga. Imamo i odgovor Uprave za kulturu, omladinu i sport za člana Labinot Mirenu. Predmetna direkcija saopštava da redovno održava sportske objekte i na taj način podržava njihove sportske aktivnosti kao i slučaj rasvete u Sportskoj dvorani „Adem Jašari“. Predmere su unapred urađene i ovih dana će biti renovirana rasveta kroz ugovore sa NPL „Kastrioti“ dd. tako da je razvoj sporta uglavnom na pravom nivou kao i uvek.

**Jeton Mjekiki** - Doneli smo odluku kao Skupština da isplatimo akcionare NPL „Kastrioti“, ali do sada nismo dobili nikakav odgovor. Koliko znam, ja sam akcionar i nismo primili naknade i želim da znam da je potrebno da se završi izmena te odluke koju smo doneli u Skupštini ili gde je problem.

**Presedavajući** – Pojašnjava da je odluka zakonita i da neće biti izmene te odluke, ali ovo pitanje ostaje za interne propise NPL „Kastrioti“ kada ih donešu. Moram to još jednom da naglasim, što je zabrinjavajuće jer Komisija koja je zadužena za kompaniju „Čišćenje“ prima naknadu, a ova Komisija je ne prima.

**Sami Ahmeti** – Ja imam molbu nekih građana Leskovcica, koji kažu da od sela C.Vodice nema osvetljenja.

**Jeton Mjekiqi** – Mi smo doneli odluku za put Obilić – Grabovac i nemamo ništa konkretno o asfaltiranju, niti o otvaranju dve prolazne tačke, koje je KEK uklonio. Život je postao veoma težak i građani imaju poteskoca, tako da će biti potrebno nekoliko dana da dobijemo bilo kakav zvaničan odgovor od KEK-a.

Sastanak je završen u 12:25' časova.

Stručno lice za posao SO

Azize Zeneli

Presedavajuća skupštine opštine

Vlora Mjekiqi Kabashi

